



**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.) "ASALB"**  
**ME ORTAKËRI**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.), e quajtur "ASALB" përbehet nga ortakët :

1. **Asllan Muharremi**, i biri i Ramazanit dhe i Havas, i datëlindjes 26.04.1951, banues ne Tirane, Rr."Jordan Misja", Nr.147, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pashaportë Nr.096432, me kombesi dhe shtetësi shqiptare.
2. **Alban Aliko**, i biri i Reshatit dhe i Merjemes, lindur mr 21.01.1969, banues ne Tirane, Rr."Kongresi i Manastirit", Pall.46/4, Ap.35, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pashaportë Nr.0162886, me kombesi dhe shtetësi shqiptare.

Ne mbështetje të ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit 7667 dt.28.01.1993 "Për rregjistrim tregtar", ortakët me vullnetin e tyre të lire hartuan aktin e themelimit si me poshtë:

**NENI 1**

Palet me vullnetin e tyre të lire krijuan Shoqërine me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.) "ASALB" me ortakëri.

**NENI 2**

Selia e shoqërise do të jetë ne Tirane, Rruga "Reshit Petrela", Nr.53. Me vendim të asamblese se ortakeve sipas dispozitave përkatëse ne këtë marreveshje dhe ne statut, shoqëria mund të hape dege, filiale e shoqëri dhe ne qytete të tjera, brenda dhe jashtë vendit.

**NENI 3**

**Objekti i verpimtarisë se SH.P.K."ASALB" do të jetë :**

**TREGTI: Eksport-Import, me shumice dhe me pakice.**

Tregtimi i mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale.

Tregtimi i karburanteve e vajrave lubrifikante, të produkteve e nenprodukteve të industrise kimike e mekanike, automjete e pjesekembimi, elektrike, elektronike, elektroshtëpiake, telefonike, materiale ndertimi e hidro-sanitare, lende drusore e mobileri, veshmbathje e manifaktura, fruta, përime, zarzavate, kafe, pije alkoholike e freskuese, dhe prodhime artizanati.



#### NENI 4

**Kapitali themelor** i shoqërise është 100.000 (nje qind mije) lek, i cili është i shlyeshem dhe i nenshkrueshem nga ortaket. Ai është vendosur nga ortaket ne kete menyre :

- |                     |                             |
|---------------------|-----------------------------|
| 1. Asllan Muharremi | 50.000(pesedhjetë mije)lek  |
| 2. Alban Aliko      | 50.000(pesedhjetë mije)lek. |

#### NENI 5

**Përqindja e fitimit dhe e humbjes** do të jetë si me poshtë :

- |                     |                         |
|---------------------|-------------------------|
| 1. Asllan Muharremi | 50%(pesedhjetë përqind) |
| 2. Alban Aliko      | 50%(pesedhjetë përqind) |

#### NENI 6

Sasia e kapitalit të kesaj marreveshje do të quhet “**kontributi i kapitalit**”, ku palet kane kuotën e tyre, treguar ne dispozitat e lartpërmendura.

Kontributi i kapitalit do të përdoret fillimisht për shpenzimet e para të shoqërise.

Secili ortak ka të drejtë t’i beje shtese kuotës se vet të kontributit të kapitalit.

Pala qe kerkon të beje shtese do t’u beje thirje ortakeve për shtesen ne kontributin e kapitalit. Kur kane kaluar 10 dite nga propozimi qe ka bere njeri nag ortaket, konsiderohet si rast mospërputhje, ne ketë rast mund të përdoret dhenia e huase.

#### NENI 7

Ne rast mospërputhje ortaket, pasi kane vedosur njezeri për shtesen ne kontributin e kapitalit, për të ruajtur përqindjen e tyre të kuotave fillestare mund t’i japin hua njeri-tjetrit. Kjo hua nuk duhet të kaloje shifren 10 % të interesit ne vit. Huaja se bashku me interesin do të paguhet me ane të fitimit qe do të rezultojë se bashku nga shoqëria, sipas përqindjes se tyre të përcaktuar ne ketë marreveshje.

#### NENI 8

Shoqëria disponon lirisht pasurine e saj dhe e përdor atë lirisht ne favor të saj, dhe të rritjes se aktivitetit të shoqërise.

#### NENI 9

Pasuria e cdo ortaku është e kalueshme lirisht ne rruge trashgimnie.

#### NENI 10

Ortaku qe del nga shoqëria i detyrohet obligimeve qe ka ndaj shoqërise. Gjithashtu edhe shoqëria i përgjigjet ndaj detyrimeve qe i ka atij.



#### NENI 11

Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve me fondet e veta. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet dhe aktivitetin që kanë ata jashtë shoqërisë.

#### NENI 12

Ortaku që kërkon të dale nga shoqëria apo të shesë pjesën e kontributit të tij, është i detyruar të njoftojë ortaket, me anë të një kerkese me shkrim një vit më parë. Dalja nga shoqëria do të bëhet vetëm me vendim të shumicës së ortakeve. Ndërsa shitja e kontributeve të tij tek të tretët bëhet vetëm pasi të jetë dhënë vendimi unanim i ortakeve.

#### NENI 13

Organi drejtues do të jetë **asambleja e ortakeve**.

Asambleja është organi më i lartë i shoqërisë.

Asambleja e shoqërisë është tërësia e ortakeve bashkepronare. Ajo realizon drejtimin e përgjithshëm të gjithë aktivitetit të shoqërisë; miraton bilanci të planet vjetore; përcakton objektivat që do të arrijë shoqëria; shton apo pakeson kontributet apo ndryshon drejtimet e veprimtarive të shoqërisë në interes të saj dhe brenda objektit të veprimtarisë. Miraton apo ben plotësime e ndryshime në statut; miraton dege, filiale e shoqëri të reja.

Emeron keshillin administrativ (administratorin), ekspert kontabel, sekretar, komisionet, avokat, arbitër, etj.; si dhe fikson e saktëson kompetencat, pagat e shpenzimet e tjera në funksion të veprimtarisë së shoqërisë.

#### NENI 14

Mbledhja e parë e asamblese së shoqërisë do të zhvillohet jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të veprimtarisë. Në këtë mbledhje do të fiksohen, saktësohen e konkretizohen të gjitha detyrimet e lartpërmendura dhe detyra të tjera në favor të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë.

#### NENI 15

Mbledhjet e asamblese janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Mbledhjet e zakonshme thirren të paktën një herë në vit, brenda katër muajve nga mbyllja e bilancit. Mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen me kërkesën e shumicës së ortakeve, në rastet e vecanta edhe me kërkesën e njerit prej ortakeve, për të shqyrtuar një rast të vecantë që ka të bëjë me zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë ose probleme të tjera të rëndësishme.



#### **NENI 16**

Asambleja si rregull mblidhet ne seline e saj qendrore të shoqërise, por mund të mblidhet edhe jashtë saj duke konkluduar vendin, kohen, rendin e ditës se mbledhjes. Procesverballi i mbledhjes se asamblese nenshkruhet nga drejtuesit (administratori), ortaket, sekretari, dhe ne raste të tjera të vecanta mund të redaktohet edhe nga noteri.

#### **NENI 17**

**Administratori** i shoqërise do të jetë Alban Aliko, i cili deri ne mbedhjen e pare të asamblese do të drejtoje veprimtarine e përgjithshme e të përditshme të shoqërise. Ky përfaqson veprimtarine përballe të tretëve, ne organet administrative, financiare e gjyqsore. Ai hyn ne bisedime e nenshkruan kontrata e marreveshje me të tretë, e jep udhezime për veprime qe duhen ndermarre nag shoqëria për plotësimin e angazhimeve dhe përmbushjen e detyrave.

#### **NENI 18**

Shoqëria do të mbaje llogarine duke u mbështetur ne lekun shqiptar dhe ne monedhe të huaj të fortë. Për ketë arsye ajo do të ketë llogarine e saj ne banke, me të cilen do të opëroje ne lek shqiptar dhe ne monedhe të huaj të fortë.

#### **NENI 19**

Shoqëria do të ketë seline ne Tirane, ajo mund të hape filiale, përfaqsi apo agjensi edhe ne qytete të tjera, brenda dhe jashtë vendit duke krijuar, sipas vleresimit të ortakeve edhe dege apo shoqëri të tjera të përbashketa. Për cdo rast ajo do të beje marreveshje të tjera e do të beje plotësime e miratime ne statutin përkatës brenda frymes se përgjithshme të kesaj marreveshjeje.

#### **NENI 20**

Bilanci i shoqërise mbyllet ne cdo 31 Dhjetor të cdo viti. Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, qe del nga bilanci do të shpërndahet si vijon :

- ◆ 5% do të destinohet për të krijuar fondin e rezerves se thjeshtë deri sa ky të mberrije ne nje të pestën e kapitalit, apo aq sa asambleja e ortakeve do t'a quaje të nevojshme.
- ◆ Mbetja do të shpërndahet sipas Nenit 5.

#### **NENI 21**

Ne rast se shpërndahet shoqëria caktohet likujdatori (komisioni i likujdimit), i cili përcakton edhe detyrat.



**NENI 22**

Shtimi i ortakëve behet me vendim të asamblese së ortakëve. Pranimi i kërkesës së kandidatëve për ortak behet me vendim unanim të ortakëve. Pranimi i ortakut behet me akt noterimi.

**NENI 23**

Cdo ndryshim e plotësim i kesaj akt-marreveshjeje do të behet nga asambleja me kërkesen, pelqimin e konsensusin e të gjithë ortakëve të shoqërise.

**NENI 24**

Mosmarreveshjet qe mund të lindin midis paleve ose trashgimtareve të tyre, do të behen përpjekje për t'u zgjidhur me mirekuptim. Ne rast se kjo rruge nuk jep rezultat, palet ceshtjen do t'a zgjidhin ne Gjykatën e Rrethit të Tiranes.

**Akti i Themelimit është hartuar me vullnet të lire dhe është firmosur nga palet.**

**ORTAKET E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR(SH.P.K.)"ASALB"**

**ASLLAN MUHARREMI**

*Asllan Muharremi*

**ALBAN ALIKO**

*ALBAN ALIKO*



## STATUTI

### VEPRIMTARISE SE SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.) "ASALB" ME ORTAKERI

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K) "ASALB" me ortake Asllan Muharremi dhe Alban Aliko, ne mbështetje të ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqëritë tregtare" dhe të ligjit 7667 dt.28.01.1993 "Per rregjistrim tregtar", ortaket me vullnetin e tyre të lirë hartuan statutin e shoqërise si me poshtë vijon:

#### NENI 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K) është emertuar "ASALB", e cila është me ortakeri.

#### NENI 2

Selia e shoqërise do të jetë ne Tirane, Rruga "Reshit Petrela", Nr.53. Shoqëria do të ketë vulen e saj – SH.P.K. - "ASALB" – TIRANE.

#### NENI 3

SH.P.K. "ASALB" do të krijojë filialet e saja ne qytete të ndryshme të vendit dhe jashtë vendit. Per krijimin e filialeve do të vendose asamblea e ortakeve me vendim të veçantë.

#### NENI 4

SH.P.K. "ASALB" do të ushtroje veprimtarine e saj ne baze të legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ndersa filialet, deget apo shoqëritë e saj qe mund të krijohen jashtë vendit, sipas legjislacionit të shteteve perkatëse.

#### NENI 5

Shoqëria ka nje kohezgjatje mbi 10 (dhjetë) vjet me të drejtën e ripertëritjes.

#### NENI 6

Objekti i veprimtarise se SH.P.K."ASALB" do të jetë :

TREGTI: **Eksport-Import, me shumice dhe me pakice.**

Tregtimi i mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale.

Tregtimi i karburantëve e vajrave lubrifikante, të produkteve e nenprodukteve të industrise kimike e mekanike, automjete e pjeseqembimi, elektrike, elektronik, elektroshtëpiake, telefonike, materiale ndertimi e hidro-sanitare, lende drusore e mobileri, veshmbathje e manifaktura, fruta, perime, zarzavate, kafe, pije alkolike e freskuese, dhe prodhime artizanati.



#### **NENI 7**

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërise pasqyrohet ne dokumentacionin e miratuar nga asamblea e ne perputhje me bilancin e saj.

#### **NENI 8**

**Kapitali** themelor i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizur (Sh.P.K.) "ASALB" është 100.000 (nje qind mije) lek. Ai perben burimin fillestar per fondin themelor të mjeteve të xhiros dhe per fillimin e veprimtarise. Ai eshte vendosur nga ortaket ne kete menyre:

- |                     |                             |
|---------------------|-----------------------------|
| 1. Asllan Muharremi | 50.000(pesedhjetë mije)lek  |
| 2. Alban Aliko      | 50.000(pesedhjetë mije)lek. |

#### **NENI 9**

**Perqindja e fitimit dhe e humbjes do të jetë si me poshtë :**

- |                     |                         |
|---------------------|-------------------------|
| 1. Asllan Muharremi | 50%(pesedhjetë perqind) |
| 2. Alban Aliko      | 50%(pesedhjetë perqind) |

#### **NENI 10**

Kuotat e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqërise jane të nenshkrueshme e të kalueshme lirisht nga ortaket.

#### **NENI 11**

Fondi rezerve i shoqërise krijohet ne masen 10% të vleres se kapitalit fillestar. Per të arritur krijimin e fondit rezerve periodikisht behet zbritje prej 10% nga fitimi i shoqërise deri sa të arrije ne shifren e caktuar.

#### **NENI 12**

Me vendim të asamblese mund të krijohet fondi i ndihmes dhe i shperblimit, i cili mund të ketë si qellim nxitjen e zhvillimit të veprimtarise krijohet çdo vit duke zbritur nga fitimi i shoqërise 5% të tij.

#### **NENI 13**

Fondet e paperdorura të nje periudhe mbarten per t'u perdorur ne periudhen pasardhese.

#### **NENI 14**

Fitimi neto i shoqërise qe do të realizohet pas shlyerjes se detyrimeve të të gjitha llojeve, dhe zbritjes se mases se nevojshme per krijimin e fondit rezerve dhe eventualisht të fondit të ndihmes e të shperblimit, do të ndahet ndermjet ortakve, ne perpjestim me kontributin e tyre ne kapitalin e shoqërise qe shenohet ne akt-marreveshjen dhe ne librin e shoqërise.



#### **NENI 15**

Detyrimet eventuale të lindura për shoqëri gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, do të mbulohen nga të ardhurat e saj, dhe kur është e nevojshme edhe nga fondet rezervë ose nga fondet e ndihmës e të shpërblimit, që do të krijohet sipas statutit.

#### **NENI 16**

Shoqëria disponon lirisht mjetet e saj financiare për përdorim në vartësi të nevojave të rrethanave. Shoqëria për kryerjen e aktivitetit të saj, ka të drejtë të hapë llogari dhe të levizë fondet e saj lirisht në bankat e tjera, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Shoqëria do të punojë me lek shqiptare e në valutë.

#### **NENI 17**

Veprimtaria e shoqërisë do të pasqyrohet në bilanci të saj, të cilat do të shprehen në lekë dhe në monedhe të huaja të fortë. Bilanci do të përfshihet në planin financiar, i cili do t'i japë pjesë planit të përgjithshëm të shoqërisë. Bilanci ekonomik-financiar i shoqërisë mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Dokumentacioni dhe bilanci do të mbahen sipas kriterëve që do të përcaktohen nga asambleja në përputhje me legjislacionin që është në fuqi.

#### **NENI 18**

Organi vendimor i shoqërisë është asambleja e ortakëve. Strukturat dhe funksionet e saj përcaktohen në marrëveshjen themelore të shoqërisë. Asambleja miraton statutin, miraton ose jo bilanci vjetor, vendos për ndryshimet eventuale të statutit, për shtimin ose pakesimin e kapitalit, për pushimin e veprimtarisë, për emerimin e administratorit apo organeve drejtuese, etj. Asambleja e ortakëve përcakton gjithashtu drejtimit kryesor të veprimtarisë së shoqërisë.

#### **NENI 19**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen ndërmjet kontratës së punës, që do të lidhet nga të interesuarit në përputhje me legjislacionin që është në fuqi.

#### **NENI 20**

### **TË DREJTAT E ORTAKEVE TË SHOQËRISË**

Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë siç përcaktohet në marrëveshjen e paleve nga ky statut ose nga aktet e tjera në bazë të saj.

Të marrë pjesë në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë siç përcaktohet në aktet në bazë të saj.

Të kërkojë dhe të ketë në dispozicion të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjithë dokumentacionin e shoqërisë ku pasqyrohet kjo veprimtari si bilanci, llogaritë, etj.





## NENI 21

### DETYRAT E ORTAKEVE TË SHOQËRISË

Të depozitohen kontributin e tyre.

Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet ortakëve të emërtuar ose të zgjedhur.

Të ruajnë sekretet e veprimtarisë së shoqërisë.

T'i japin shoqërisë të gjitha informacionet e nevojshme për zhvillimin e suksesshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.

## NENI 22

Çdo pale ka të drejtë të tërhiqet nga shoqëria duke njoftuar me shkrim një vit përpara. Largimi nga shoqëria nuk e ç'liron palen përkatëse nga detyrimet financiare që ajo ka marrë për shërbime ndaj shoqërisë gjatë qenies si pale në të.

## NENI 23

Aktualisht me konsensus administratori i shoqërisë është Alban Aliko.

Ai do të drejtojë e organizojë gjithë veprimtarinë e shoqërisë. Ai ka të drejtën e firmës për tërheqje e depozitim të parave në banke. Në mungesë të tij këto detyra do t'i kryejë Asllan Muharremi.

## NENI 24

Brenda tre muajve nga data e krijimit të shoqërisë duhet të mbledhet asambleja e ortakëve, e cila do të analizojë e konfirmojë:

- ◆ Punën, arritjet e veprimtarisë së shoqërisë që nga krijimi e deri në datën e mbledhjes.
- ◆ Detyrimet e objektivat ekonomiko-financiare të shoqërisë për të ardhmen.
- ◆ Do të konfirmojë organet drejtuese të shoqërisë, kompetencat dhe detyrimet e tyre, pagat vjetore të tyre, shpenzimet e nevojshme zyrtare, kancelarike, etj.

## NENI 25

Në vartësi të zhvillimit ekonomiko-financiar të shoqërisë, organet e saj drejtuese mund të jenë : 1-2 administratorë apo Këshilli Administrativ i ndihmuar nga 1-2 sekretarë; ekspert kontabel; komisioner, etj.

Sasia e tyre do të varet nga gjendja financiare e shoqërisë.

Në organet drejtuese të shoqërisë (administrator apo këshill administrativ) mund të jenë ortakët e shoqërisë ose jashtë saj.

**NENI 26**

Veprimtaria e shoqërise pushon nga aktiviteti sipas propozimit të bere nga palet, kur gjatë dy vjetëve të fundit të njepasnjeshme veprimtaria e saj nuk është efektive, palet heqin dore prej saj, kur mbaron afati dhe kur nuk egziston asnje mundesi per vazhdimin e veprimtarise se shoqërise.

**NENI 27**

Per likujdimin e shoqërise emerohet komisioni i likujdimit ose likujdatori.

**NENI 28**

Komisioni i likujdimit ose likujdatori brenda nje viti nga data e hyrjes ne funksion duhet të paraqesin relacionin e likujdimit ne mbledhjen e asamblese se ortakeve.

**NENI 29**

Shoqëria pushon veprimtarine e saj vetëm ne çastin e miratimit të relacionit të komisionit të likujdimit.

**NENI 30**

Mjetet financiare të fituara gjatë veprimtarise se shoqërise dhe fondi themelor ndahet ndermjet ortakeve.

**NENI 31**

Shoqëria mund të shperndahet ne formen e riorganizimit ose të likujdimit.

**NENI 32**

Mosmarreveshjet eventuale të lindura ndermjet paleve do të zgjidhen sipas menyrave të percaktuara të aktit të themelimit të shoqërise.

**NENI 33**

Per sa nuk është shprehur ne këtë statut i referohet çdo ligji të veçantë perkatës dhe legjislacionit shqiptar, veçanerisht ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera qe do të shpallen per këtë qellim.

**Statuti është hartuar me vullnet të lirë dhe është firmosur nga palet.**

**ORTAKET E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR(SH.P.K.)"ASALB"**

**ASLLAN MUHARREMI**

*Asllan Muharremi*

**ALBAN ALIKO**

*ALBAN ALIKO*